

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



**PUNIM MASTER**

**TEMA : NDIKIMI I INFRASTRUKTURES SHKOLLORE NË REALIZIMIN E  
DETYRAVE TË LËNDËS EDUKATA FIZIKE DHE SPORTIVE NË KOMUNËN E  
MALISHEVËS**

**TOPIC: THE INFLUENCE OF SCHOOL INFRASTRUCTURE ON REALIZATION OF  
DUTIES OF PHYSICAL EDUCATION SUBJEKT IN MALISHEVA MUNICIPALITY**

**Mentori :**  
**Prof. Dr. Shqipe Bajçinca-Brestovci**

**Kandidati:**  
**Xhelal Bajra**

Tema e prezantuar

nga

**Xhelal Bajra**

pranë

**DEPARTAMENTI EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT**

në plotësimin e pjesëshëm të obligimeve

për të fituar titullin:

**MASTER I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT**

Tetor, 2018



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT**

**Prishtinë**

Aprovuar nga:

Shqipe Bajçinca-Brestovci Prof. Dr.- Mentore

---

---

---

## FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE

Mirënjohje dhe falënderimet të sinqerta për prindërit e mi, të cilët me mbështetjen e pakufishme, më ndihmuan gjatë gjithë rrugëtimit tim akademik, për të arritur në përfundimin e studimeve Master.

Veçanërisht e falënderoj mentorin tim Prof. Dr. Shqipe Bajçinca-Brestovci për këshillat, sygjerimet, e cila më ka ofruar mbështetjen e realizimit të studimit. Unë i jam mirënjohëse për bashkëpunimin. Do të jetë udhërrefyes dhe model në punën time akademike.

Falënderime të veçanta për mesimdhënsit e shkollave në komunën e Malishevës të cilët plotësuan pyetësorët dhe iu përgjigjën intervistave në mënyrë të sinqertë.

*Përgjithmonë mirënjohëse!*

## Lista e Figurave

Fig.1. Veshja sportive e nxënësve.

Fig.2. Ushtrime fizike.

Fig .3. Fusha sportive

Fig.4. Topat

Figura. 5. Fusha volejbollit.

Figura .6. Fusha tenisit.

Figura .7 Fusha e pingpongut.

Figura.8.Fusha futbollit.

Figura .9. Fusha Hendbollit.

## **Lista e Tabelave:**

**Tabela 1** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) –  
Niveli pedagogjik i arsimtarit

**Tabela 2** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) –  
A posedon shkolla juaj sallë të edukatës fizike dhe sportit?

**Tabela 3** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Sa është e  
kënaqshme gjendja ekzistuese e sallës së edukatës fizike dhe sportit?

**Tabela 4** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - A posedon  
shkolla juaj poligone sportive?

**Tabela 5** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Sa është e  
kënaqshme gjendja ekzistuese e poligoneve sportive?

**Tabela 6** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Sa ka hapësira  
brenda sallave të edukatës fizike dhe sportit?

**Tabela 7** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Sa është  
hapësira e poligoneve sportive nëpër shkolla?

**Tabela 8** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Sa janë të  
shfrytëzueshme rekuizitat sportive në sallën e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?

**Tabela 9** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Në çfarë niveli  
janë rekuizitat sportive që posedon salla e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?

**Tabela 10**- Pyetja për shkollat fillore - Sa realizohet planprogrami i orës së edukatës fizike dhe  
sportit?

**Tabela 11.** Sa është numri i orëve të lëndës së edukatës fizike dhe sportit për një javë?

**Tabela 12-** Pyetja për shkollat e mesme - Sa është i harmonizuar niveli shkollor me planprogramin mësimor?

**Tabela 13-** Pyetja për shkollat fillore - Zhvillimi i njësive mësimore. Si e zhvilloni një njësi mësimore në lëndën e edukatës fizike dhe sportit apo (sa përqind e zhvilloni një njësi mësimore në lëndën e edukatës fizike dhe sportit)

**Tabela 14** - Pyetja për shkollat fillore - Sa përqind e realizoni orën mësimore të lëndës së edukatës fizike dhe sportit me teori?

**Në tabelën 15** është paraqitur pyetjet “Sa përqind e realizoni orën mësimore të lëndës së edukatës fizike dhe sportit me teori dhe praktikë?” tek shkollat fillore. Në nivelin e shkollimit fillor dhe të mesëm shumica e përgjigjeve për realizimin e orëve në teori dhe në praktikë janë dhënë në 60-80%.

**Tabela 16-** Pyetja për shkollat e mesme - Sa është përqindja e shfrytëzimit të këtyre ambienteve në realizimin e orëve mësimore?

**Tabela 17** - Pyetja për shkollat fillore - Sa janë funksionale këto ambiente gjatë realizimit të orës së edukatës fizike dhe sportit

## **PËRMBAJTJA**

<b>1.Hyrje</b> .....	8
2. Hulumtimet e deritanishme.....	10
<b>3. QËLLIMET DHE DETYRAT E EDUKATËS FIZKE</b> .....	11
3.1. Mësimdhënësi i lëndës së edukatës fizike .....	14
4. Resyme –Rekomandime: .....	16
5.Hipotezat themelore .....	23
<b>6.METODA E HULUMTIMIT</b> .....	24
6.1 Mostra e entiteteve.....	24
6.2 Mostra e ndryshoreve.....	24
6.3 <i>Parametrat themelor statistikor</i> .....	30
6.4. Metoda e përpunimit të rezultateve.....	22
6.5. Kushtet e realizimit të pytësorit.....	23
<b>7.PËRFUNDIMI</b> .....	51
<b>8. LITERATURA:</b> .....	53

## Hyrje

Fusha mësimore “Edukim fizik, sport edhe shëndet” është pjesë integrale e procesit arsimorë, pa të cilën arsimimi i fëmijës do të ishte i paplotë, por njëkohësisht një fushë e cila dallohet nga fushat e tjera kurrikulare, pasi fokusi primar i saj është mbi trupin, përvojat fizike dhe shëndetin e njeriut. Komuniteti shëndetit publik po bëhet gjithnjë e më i interesuar për kontributet e padiskutueshme të edukimit fizik shkollor në shëndetin e fëmijëve.

Edukimi fizik është parë si një mjet ideal për promovimin e aktivitetit të rregullt fizik dhe edukimin e një stili jetes aktive dhe fusha mësimore “Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti” në arsimin parauniversitar ndihmonë që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe kompetencat e nevojshme, të cilat sigurojnë mirëqenien e shëndetit të tyre mendor, emocional, fizik dhe social. Kultura fizike pra është pjesë e rëndësishme e kulturës së përgjithshme të një vendi (kombi) që ka vlera mbarë shoqërore dhe materiale të pasqyruara në institucionet shtetërore e shoqërore, si dhe në sistemet e edukimit fizik, të cilat janë të njohura në historinë e shoqërisë njerëzore.

Ne kuptimin e ngusht kultura fizike përfaqëson dhe shpreh një tërsi dijsh ku përfshihet një vëllim i caktuar njohurish e aftësish me karakter historik, pedagogjik. Psikologjik, shkencorë e praktikë që i shfaq individit në jetën e përditshme, private ose shoqërore. Këto dije kanë karakter konkret dhe lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin fizik, me edukimin fizik, me sportin, me shëndetin me çlodhjen fizike dhe psikike. Kur njeriu arrin t’i shfaq dukshëm njohurit dhe aftësit e tij në veprimtarin e përditshme atëherë mund të quhet se ka kulturë fizike. Sikurse në të gjitha vendet e botës edhe tek ne edukimi fizik është lëndë e detyrueshme (obligueshme) mësimore në planet shtetërore dhe përfshinë të gjitha sistemet e arsimimit të brezit të ri, që nga mosha parashkollore deri në atë universitare, me një ngarkesë që shkon nga 2-5 orë mësimore në javë. Dihet se kultura fizike ka të bëjë me edukimin përmes lëvizjeve të ndryshme trupore dhe se ndikon në edukimin e përgjithshëm të njeriut.



Vlera dhe rëndësia e lëndës Edukata Fizike është shumë e rëndësishme për jetën e njeriut, mirpo për fatë keqësishte në Kosovë kësaj lënde nuk i jepet rëndësi dhe vend i merituar.

Sipas didaktikës në organizimin e procesit mësimorë, kjo lëndë ndikon në përmirësimin e forcës, qëndrueshmërisë, fleksibilitetit, aftësit kognitive etj

Të gjitha planprogramet mësimore, lëndën Edukata Fizike e kanë inkuadruar si një nga lëndët që shërben për qllirimin e energjisë fizike dhe mendore të nxënësve, të shkollave fillore po ashtu edhe të mesme lëvizjet dhe lojrat paraqiten si nevojë e kushtëzuar për zhvillimin e zakonshëm psikofizik që nënkupton përmirësimin e aftësive atropometrike , biometrik edhe funksionale.

## **Hulumtimet e deritanishme**

Kemi një numer të madh punimesh të cilat janë realizuar nga autore të ndryshëm, mirpo hulumtimet e kësaj natyre nga autorët vendorë mungojnë plotësisht.

Nga punimet e autorëve të jashtëm vërehët shumë punime kërkimore , të cilët na tregojnë që nxënësit të cilët kanë një orjentim të brendshëm motivues përdorin strategji njohëse , më shumë se nxënësit që kanë orjentim të jashtëm motivues.

Për deri sa ka një numër të madh faktorësh që ndikojnë në performancën shkollore dhe suksesin e nxënësve , një ndikim i madh është edhe infrastruktura shkollore, që motivimi i nxënësve të jet sa më i madh.

Të hulumtosh do të thotë përkushtim i madh, prandaj lidhur me infrastrukturën dhe planprogramin e lëndës Edukta Fizike janë bërë disa hulumtime të studentëve në vendin tonë nëpër komunat e tyre, në këtë rast edhe unë zgjodha komunën e Malishevës që të hulumtojë realitetin e shkollave në këtë komunë, të vërtetojmë se a kanë shkollat në këtë komunë infrastrukturë shkollore dhe sa mësimdhënsit përdorin planprogramin e lëndës, ky hulumtim është bërë me anë të pyetësorit , në pyetësor janë përgaditur pyetje të cilave ju kanë përgjigjur arsimtarët e shkollave.

Sipas hulumtimit që kam bërë në këto shkolla , niveli pedagogjik i arsimtarëve në këto shkolla është në nivel, ndërsa infrastruktura është më e lartë në shkollat e mesme se në shkollat fillore, kurse realizimi planprogramit të lëndës zhvillohet në nivel të duhur.

## QËLLIMET DHE DETYRAT E EDUKATËS FIZKE

Qëllimi i hulumtimit ka të bëjë me ndikimin e infrastrukturës sportive shkollore në realizimin e planprogramit të lëndës së Edukatës Fizike dhe Sportive në Komunën e Malishevës. Qëllim tjetër i këtij hulumtimi është të dihet sa realizohen kategoritë nga syllabusi i lëndës së Edukatës Fizike dhe Sportit duke iu referuar infrastrukturës.

Qëllimi parësorë i këtij hulumtimi është të arrijm të bëjmë vlerësimin e infrastrukturës sportive nëpër shkolla, gjithashtu duhet të vërtetojmë nëpërmjet parametrave të parashtruar në këtë punim se sa infrastruktura e sportit ndikon në zhvillimin dhe aftësimin e nxënësve për lëndën e edukatës fizike dhe sportit.

Po ashtu gjatë këtij punimi duhet të vërtetojë nivelin pedagogjik të mësimit nëpër shkollat që janë duke zhvilluar mësimin nëpër shkolla ku do ta bëjë hulumtimin. Duke u nisur nga rëndësia që ka infrastruktura shkollore për realizimin sa më të suksesshëm të planprogramit mësimor të lëndës së edukatës fizike në një vënd, e në këtë rast në Komunën e Malishevës, me anë të këtij hulumtimi si qëllim tjetër i këtij studimi është që të njihemi më afër me probleme të ndryshme rreth infrastrukturës shkollore (gjendjen aktuale), rreth harmonizimit të planprogramit mësimor, zhvillimin e njësive mësimore, harmonizimin e planit mësimor me nivelin shkollor si dhe me nivelin e edukimit (shkollimit) të mësimit në nivelin fillor dhe atë të mesëm.

Qëllimi tjetër i këtij hulumtimi është të vëre theksin mbi rëndësinë që ka edukata fizike për vetëdijësimin e nxënësve dhe të popullatës mbi arsyet se pse duhet të merren me aktivitete fizike si dhe përfitimet fizike dhe psikologjike që sjell të ushtruarit aktiv në jetën e atyre që merren me aktivitet fizik.

Edukata fizike dhe sportive në shkollën e mesme të ulët, e vënë nxënësin në kontakt me një numër të madh aktivitete fizike, sportive e artistike. Sipas natyrës së tyre këto aktivitete e privilegjojnë një mënyrë të posaçëshmë të relacioneve dhe adaptimeve përballë rrethit fizik dhe njerzor. Ajo i mundëson të gjithë nxënësve që të provohet fizikisht dhe të njihen më mirë me përvoja të llojllojshme dhe origjinale, me burime emocionale dhe dëshirash ndihmon në zhvillimin e personalitetit.

Edukimi fizik dhe sportiv duhet të jetë mjet i zhvillimit të rëndësishëm të personalitetit; Duhet të respektojë parimin e mundësive të barabarta për të gjithë nxënësit dhe respektimin e dallimeve ndërmjet tyre;

Procesi pedagogjik të udhëhiqet ashtu që secili nxënës të jetë i suksesshëm dhe i motivuar; Loja si mjet relaksues dhe si mjet i edukimit duhet të jetë e pranishme në çdo orë të edukimit fizik;;

Programi mësimor duhet t'i inkurajojë fëmijët për marrëdhënie humane të ndërsjella sportive (fairplay);Trajtim të posaqëshëm duhet kushtuar fëmijëve me nevoja të veqanta dhe atyre të talentuar;

Të ndërlihdë veprimtaritë sportive me fushat tjera lëndore;

Programi mësimor përgaditë dhe vlerëson të arriturat e fëmijëve dhe nxitë për aktivitete të sportit;

Duhet të respektojë standardet e shkruara dhe aktet normative dhe të kujdeset për siguri gjatë të ushtrimeve.

#### **Qëllimet e edukatës fizike janë:**

- Zhvillim dhe përforcim i potencialit biomotorik
- Të kënaqen nevojat me motive biosociale

- Me ushtrime sistematike dhe forma të ndryshme, të kuptohet vlera dhe rëndësia e zhvillimit të gjithanshëm me aftësi pune dhe mbrojtëse, lumturi dhe kënaqësi personale e shoqërore .

Me aktivitetet fizike, të ruhet drejt peshimi me ngarkesat e përditshme intelektuale të cilave u bashkëngjitet standardi i lartë jetësorë dhe mjetet teknike që e zvogëlojnë aktivitetin fizik.

#### **Detyrat edukative (pedagogjike) janë:**

- a) Zhvillimi i dëshirës, karakterit dhe disiplinës
- b) Qëndrimi pozitiv ndaj punës së përditshme
- c) Sjellje të diciplinar ndaj kolektivit dhe shoqërisë

- d) Zhvillim i ndjenjave patriotike
- e) Zhvillim i ndjenjave estetike
- f) Zhvillim i ndjenjave humane
- g) Të krijohen aftësi për zbavitje.

**Detyrat biologjike (higjiëno-shëndetësore) janë:**

- a) Ndikimi mbi rritjen e zhvillimin e organizmit
- b) Përmirësimi i funksionit lokomotorik
- c) Formimi i qëndrimit të drejtë
- d) Kalitja e organizmit
- e) Formimi i shprehive higjiënike
- f) Faktor i pushimit dhe argëtimit.

**Detyrat Arsimore (pedagogjike) janë:**

- a) Zhvillim i lëvizjeve të koordinuara
- b) Formimin dhe përvetësimin e shprehive lëvizore
- c) Zhvillimin e cilësive motorike
- d) Pajisja me dituri teorike.

## Mësimdhënësi i lëndës së Edukatës Fizike

Arsimtari me forcat e tij organizative, ndërton, organizon dhe zhvillon procesin mësimor, cakton metodat e qëllimet që duhet të arrihen për një kohë të caktuar. Nga aftësia dhe eksperiencia e tij varet lidhshmëria e njohurive të reja, me ato të mësuara më parë.

Arsimtari duhet të jetë i gatshëm ta ndihmojë veprimtarin e nxënësve, ti kontrollojë dhe ti korrigjon ushtrimet e ekzekutuara, ndihma të jetë e matur dhe në kohë të duhur. Ai asnjëherë nuk guxon ta konsideron veten të përsosur në njohurit e tij, por vazhdimisht të studiojë literaturë në lidhje me temat mësimore.

Përgatitja e tij për orën e edukatës fizike, bëhet një ditë para mësimit.

Gjithmonë mësimi zhvillohet në bazë të planit të caktuar i cili përcakton përmbajtjen e mësimit i udhëhequr nga qëllimet, detyrat, metodat e mësimit dhe format organizative. Plani i hartuar në formë konkrete, duke marrë parasysh moshën, gjininë, kushtet materijale dhe kushte klimatike, është kusht dhe mjet për realizimin e plot të procesit edukativo-arsimor. Struktura e orës të edukatës fizike në rethanat tona përmbanë katër pjesë: pjesa hyrse, përgatitore, kryesore dhe përfundimtare.

Ndarja e mësimit në pjesë, është detyrë pedagogjike që ndihmonë në ngritjen e cilësive mësimore, përcakton detyrat metodike dhe ngarkesën fiziologjike për fazat e mësimit.

Pjesa hyrse është suksesi i orës varet edhe prej fillimit të saj, prandaj mësimi duhet të fillojë në mënyrë të organizuar. Duke marrë parasysh dëshirën e madhe të nxënësve për edukatë fizike, ata zakonisht në orë arrijnë me një disponim të këndshëm që siguron ambientin e punës.

Nxënësit duhet në mësim të vijnë të përgatitur me veshje sportive. Disiplina dhe rregulli janë kushte të domosdoshme me qenë se mësimi i edukatës fizike, ndër të tjerat ka për qëllim edukimin e disiplinës, mirësjelljes dhe rregullave. Organizimin e pjesës hyrse, arsimtari e bën me anë të lojës ose në mënyrë klasike (me ecje, vrapime dhe kërcime të ndryshme). Për cilën varijantë do të përcaktohet, më së shumti varet nga gjendja emocionale e nxënësve. Në qoftë se gjendja psikike është e plogësht, atëherë në pjesën e parë të orës, për përmirsimin e gjendjes

psiqike, dhe për pregatitjen e organizmit në mënyrë graduale e të gjithanshme, ndërmiren lojra të ndryshme, ecje me këngë ose kapërcime pengesash.

Pjesa përgatitore me anë të ushtrimeve bën përgatitjen e përgjithshme të organizmit për pjesën kryesore të mësimit.

Gjatë ekzekutimit të ushtrimeve trupore, pa marrë parasyshë formacionin e rreshtimit (në radhë, në reth ose lirisht të shpërndarë), nxënësit duhet të kenë distancë të nevojshme mes tyre, që të jenë në gjendje të bëjnë ushtrimet pa penguar njëri tjetrin. Në pjesën përgatitore të orës e cila zgjatë 8-12 minuta, përpqemi të arrijmë një ngrohje të matur të organizmit, e cila shfaqet në gjallërimin e veprimtarisë së organeve të frymëmarrjes dhe gjakqarkullimit, në përgatitjen e muskujve me ushtrime të përshtatura. Ngrohja dhe shkrithja e organizmit, ngrenë aftësinë dhe gadishmërinë e tij për realizimin e njësisë mësimore.

Pjesa përfundimtare ka për qëllim në mënyrë aktive ta kthejë organizmin e tensionuar dhe të lodhur të nxënësve në gjendje normale fiziologjike. Pas pjesës themelore, mësimi duhet të përfundojë në mënyrë të organizuar, prandaj në pjesën përfundimtare të mësimit, ndërmiren aktivitete që mundësojnë organizmi i nxënësve brenda 3-5minuta, të zbresë prej ngarkimit të lartë fiziologjik, në nivel që ka qenë në fillimin e orës mësimore. Detyra kryesore e arsimtarit është që me mjete të posaçme dhe për kohë të shkurtër, ta normalizon gjendjen psikofizike dhe ti përgatisë nxënësit për mësimin që vijon

Arsimtari me forcat e tij organizative, ndërton, organizon dhe zhvillon procesin mësimor, cakton metodat e qëllimet që duhet të arrihen për një kohë të caktuar. Nga aftësia dhe eksperiencia e tij varet lidhshmëria e njohurive të reja, me ato të mësuara më parë. Arsimtari duhet të jetë i gatshëm ta ndihmojë veprimtarin e nxënësve, ti kontrollojë dhe ti korrigjojë ushtrimet e ekzekutuara, ndihma të jetë e matur dhe në kohë të duhur. Ai asnjëherë nuk guxon ta konsideron veten të përsosur në njohurit e tij, por vazhdimisht të studiojë literaturë në lidhje me temat mësimore. Përgatitja e tij për orën e edukatës fizike, bëhet një ditë para mësimit.

Vlerësimi përfundimtar, është konkluzë e fundit e arsimtarit mbi efektin e përgjithshëm të punës së çdo nxënësi. Ai bëhet në fund të gjysmëvjetorit, respektivisht në fund të vitit në bazë të

rezultateve që nxënësi i ka arritur gjatë vitit shkollor. Arsimtari duhet ta bëjë vlerësimin në bazë të interesimit, përpjekjes dhe sjelljes të nxënësit ndaj ushtrimit trupor, e jo vetëm në bazë të aftësive të tij fizike.

Nxënësi duhet të jetë i bindur se nota e vlerësimit është objektive dhe përmban të gjitha elementet e aktivitetit vjetor të tij. Arsimtari, vlerësimin duhet ta bëjë publikisht dhe të argumentuar, ashtu thellohet besimi i nxënësve ndaj tij.



## Resyme –Rekomandime:

Hulumtimi është bërë në shkollat e komunës së Malishevës ku janë përfshirë 33 shkolla dhe 10 jan më të përzgjedhura.

Hulumtimi ka treguar se në shkollat e kësaj komune gjendja nuk është e kënaqshme sidomos në shkollat fillore për realizimin me sukses të lëndës Edukata Fizike, për arsye se ndikojnë shumë faktorë, mungesa infrastrukturës, poligoneve sportive rekuzitave etj.

Duke e ditur rëndësin e lëndës që Edukata Fizike është proces i domomosdoshëm për nxënës me qëllim që nxënësit të fitojnë njohuri, shkathtësi, shprehi lëvizore ndikon në zhvillimin organizmit të fëmijëve duke eliminuar paraqitjet eventuale të devijimeve për shkak të ndikimit të pozitës së qëndrimit të ndenjtur gjatë në bankat shkollore, kjo lëndë ndikon në përmirësimin e forcës, qëndrueshmërisë, fleksibilitetit, shpejtësisë, përmirësimin e shëndetit ku i aftëson nxënësit për mënyrën e jetesës.

- Prandaj unë rekomandojë që duke parë këtë rëndësi që ka për fëmijën lënda Edukata Fizike të shtohet numri orëve nga 2 orë në javë të bëhet 3 orë në javë, të investohet në infrastrukturë, në numrin e sallave ,rekuzitave, për të kultivuar shprehi higjenike, vitalitetin dhe krijimin e optimizmit për të jetuar .
- Rekomandojë që gjatë edukimit fillorë dhe të mesëm është shumë me rëndësi që nxënësit të fitojnë shprehi higjenike të kenë paisje sportive gjatë orës, me qëllim që të arrihet rezultat sa më i lartë.



**Fig.1. veshja sportive e nxënësve.**

Pasi shkolla është mjedisi më i rëndësishëm që ka si mision krijimin e shprehive, bindjeve dhe vlerave për edukimin fizik. Sot misioni i shkollës ka devijuar, duke privilegjuar më shumë

aspektin teorik dhe duke nënvlerësuar zhvillimin fizik. Ky devijim i balancës së edukimit dhe zhvillimit ka pasoja negative të rinia dhe fëmijët, krijon një impakt negativ që e shoqëron më pas njeriun përgjatë gjithë jetës. Edukimi fizik në shkollë sot vuan pasojat e një nënvlerësimi tradicional në raport me edukimin mendor.

Prandaj lënda e edukimit fizik në shkolla duhet reformuar që nga emri i tij deri te përmbajtja. Ambientet sportive në shkolla janë të pashfrytëzuara plotësisht, sot ka nevojë urgjente për mjedise të reja sportive. . Moshë e shkollës është optimalja për të përfituar nga aktiviteti i rregullt fizik dhe për ta kthyer më pas atë në një kulturë të përditshme. Për këtë arsye rekomandojmë se duhet edhe mbështetja e prindërve dhe organizatave sportive si dhe një vëmendje gjithnjë në rritje e shoqërisë për aktivitetin fizik të të rinj. Ora edukimit fizik të jetë e larmishme, sidomos në shkollat e mesme. Gjithashtu, të hapen mjediset sportive të shkollave duke krijuar kushte të reja administrimi.

## Rekomandim për Ministrin e Arsimit.

- Rekomandoj që në shkollat fillore dhe të mesme, të krijohen salla të përshtashme për realizimin e aktiviteteve sportive me qëllim që të arrihet rezultat i sukseshëm në përfitimin e njohurive të nxënësve.



Fig.2. Ushtrime fizike.



Figura .3. Fusha sportive



Figura .4. Topat.



Figura. 5. Fusha volejbollit.



Figura .6. Fusha tenisit.



Figura .7 Fusha e pingpongut.



Figura.8.Fusha futbollit.



Figura 9 - Fusha Hendbollit

## **Hipotezat themelore**

Në bazë të hulumtimeve që janë bërë deri më tani të cilat kanë trajtuar këtë hapësirë si dhe në bazë të problemit, lëndës dhe qëllimit të hulumtimit, kam paraqitur këto hipoteza:

- **Hipoteza 1**

Pres që infrastruktura në objektet shkollore ku mbahet mësimi i edukatës fizike të mos jetë në nivel të duhur në komunën e Malishevës.

- **Hipoteza 2**

Pres që dallimet në infrastukure sportive ndërmjet shkollave fillore dhe të mesme të mos ket dallime të mëdha.

- **Hipoteza 3**

Shpresojë që planprogrami i orëve të edukatës fizike është dukeu realizuar sipas planifikimit në shumicën e shkollave fillore dhe të mesme në komunën e Malishevës.

## **Metodat e Hulumtimit**

### **Mostra e entiteteve**

Për të realizuar këtë projekt nga secila shkollë janë marrë të dhëna nga arsimtarët e edukatës fizike në formë të pyetësorit në shkollat fillore dhe të mesme në komunën e Malishevës. Këto shkolla duhet të zhvillojnë mësimin e rregullt në orët e edukatës fizike dhe sportit.

Grupin e përbëjnë afërsisht 10 shkolla të cilat do të jenë nga komuna e Malishevës.

Kriteri themelor për testimin e subjekteve ka qenë mbajtja e rregullt e orëve të Edukatë Fizike në shkollat fillore dhe të mesme në komunën e Malishevës

### **Mostra e ndryshoreve**

Për të realizuar këtë punim sa më mirë kemi marrë disa variabla në formë të pyetësorit të cilat do ti plotësojnë arsimtarët e edukatës fizike dhe sportit në shkollat ku ata punojnë: në grupin e parë të variablave e përbëjnë pyetjet për përgatitjen profesionale (edukimin) e profesorëve të edukatës fizike, përvoja e punës si dhe niveli i punës (fillor - mesëm), gjendjen e infrastrukturës sportive në shkollë, hapësira në të cilën zhvillohet lënda e edukatës fizike dhe sportit, dhe në grupin e dytë hyjnë variablat të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin dhe realizimin e lëndës së edukatës fizike dhe sportit.

#### Gjendja e infrastrukturës sportive në shkollë

1. Numri i sallave të edukatës fizike dhe sportit
2. Numri i poligoneve sportive nëpër shkolla
3. Hapësira brenda sallave të edukatës fizike dhe sportit
4. Hapësira e poligoneve sportive nëpër shkolla
5. Rekuizitat sportive brenda në sallën e edukatës fizike dhe sportit



6. Terrenet e hapura
7. Realizimi i lëndës së edukatës fizike dhe sportit.
  1. Harmonizimi i Planprogramit te orës së edukatës fizike dhe sportit
  2. Mjetet e punës gjatë orës së edukatës fizike dhe sportit
  3. Numri i nxënësve prezent gjatë orës së edukatës fizike dhe sportit
  4. Numri i orëve të lëndës për një javë
  5. Zhvillimi i njësive mësimore
  6. Niveli shkollor a është i harmonizuar me planin mësimor.

### **Metoda e përpunimit të rezultateve**

Metodat e përpunimit të rezultateve janë parashtruara qëllimit dhe natyrës së punimit.

Në bazë të qëllimit të parashtruar është zgjedhur edhe metodologjia e përpunimit të rezultateve:

Parametrat themelore statistikore:

- Numri i përgjigjieve ( count) – përqindja
- Paraqitja në tabel dhe grafike e pyetësorit.

## **Kushtet e realizimit të pytësorit**

Procedurat e plotësimit të pytësorit janë realizuar në atë mënyrë që të gjithë arsimtarëve në në Komunën e Malishevës u është dhënë informatë në lidhje me plotësimin e pytësorit rëndësin dhe anën kofidenciale të tijë.

Procedurat se si duhet të plotësohet pytësori janë shpjeguar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe nëse ka pasur diqka të paqartë kanë pasur mundësi të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigjie adekuate për të plotësuar në mënyrë të drejtë pytësorin.

Të dhënat personale të tyre si emri dhe mbiemri nuk kanë qenë të rëndësishme dhe ata nuk kanë pasur nevojë që ti paraqesin në pytësorë, gjithashtu nuk kanë pasur nevojë që të nënshkruajnë në pytësorë.

**Me poshtë është paraqitur pyetësori të cilit ju kan përgjigjur arsimtsrët e shkollave.**

# PYETSOR

## 1. Niveli pedagogjikë i arsimtarit?

- a. Shkolla e lartë pedagogjike (2 vjeçare)
- b. Studimet themelore
- c. Studimet bechaler
- d. Studimet master
- e. Studimet magjistraturë
- f. Studimet doktoraturë

**Nëse keni ndonjë nivel arsimor që nuk është përfshi më lart shëno me fjalë:**

.....

---

## 2) Gjendja e infrastrukturës sportive në shkollë?

- a. A posedon shkolla juaj sallë të edukatës fizike dhe sportit?  PO  JO

(Nëse përgjigja është PO kalo në pyetjen b)

- b. Sa është e kënaqshme gjendja ekzistuese e sallës së edukatës fizike dhe sportit ?

(Shëno në katrorët 5 është e kënaqshme, ndërsa 1 nuk është e kënaqshme)

5  4  3  2  1

- c. A posedon shkolla juaj poligone sportive?

(Nëse përgjigja është PO kalo në pyetjen d)

PO  JO

- d. Sa është e kënaqshme gjendja ekzistuese e poligoneve sportive?

5  4  3  2  1

- e. Sa ka hapësira mbrenda sallave të edukatës fizike dhe sportit ?

mjaftueshem  pamjaftueshem

- f. Sa është hapësira e poligoneve sportive nëpër shkollë?

mjaftueshem  pamjaftueshem

- g. A janë të pajisura me rekuizita sportive sallat e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?

PO  JO  Pjesërishtë

**h. Sa janë të shfrytëzueshme rekuizitat sportive në sallën e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?**

5       4       3       2       1

**i. Në çfarë niveli janë rekuizitat sportive që posedon salla e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?**

5       4       3       2       1

**j. A ka shkolla terrene të hapura të cilat shfrytëzohen për realizimin e lëndës së edukatës fizike dhe sportit?**

*(nese po kalo ne pyetjen e k)*

PO       JO

**k. Sa janë të shfrytëzueshme terrenet e hapura për realizimin e lëndës së edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?**

5       4       3       2       1

---

**i. Sa është përqindja e shfrytëzimit të këtyre ambienteve në realizimin e orëve mesimore**

sallën e edukatës fizike dhe sportit

100%     80%     60%     40%     20%

terrenet e hapura

100%     80%     60%     40%     20%

klasën mesimore

100%     80%     60%     40%     20%

poligonet sportive

100%     80%     60%     40%     20%

**j. Sa janë funksionale këto ambiente gjatë realizimit të orës së edukatës fizike dhe sportit?**

sallën e edukatës fizike dhe sportit

5     4     3     2     1

klasa mesimore

5     4     3     2     1

terrenet e hapura

5     4     3     2     1

poligonet sportive

5     4     3     2     1

## REZULTATET DHE DISKUTIMI

### 6.5 Parametrat themelor statistikor

**Tabela 1** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) –  
Niveli pedagogjik i arsimtarit


Label	Niveli pedagogjik i arsimtarit	SHMU		SHML	
		Valid	Missing	Valid	Missing
		33	0	2	0
		Count	Percent	Count	Percent
1	Shkolla e lartë pedagogjike (2 vjeçare)	2	6.06%	0	0.00%
2	Studimet themelore	3	9.09%	0	0.00%
3	Studimet bechaler	15	45.45%	0	0.00%
4	Studimet master	8	24.25%	2	40%
5	Studimet magjistraturë	0	0	3	60%
6	Studimet doktoraturë	0	0.00%	0	0.00%

Në tabelën 1 është paraqitur niveli pedagogjik i arsimtarëve të shkollës fillore dhe të mesme. Me nivel të studimeve bechaler janë 45.45% të arsimtarëve të edukatës fizike të cilët janë të angazhuar në shkollat fillore, prej tyre studimet master kanë kryer 24.25%, kurse me studime themelore dhe shkollë të lartë kemi së bashku 9.09%.

Në shkollat e mesme janë të angazhuar 40% me studime master, ndërsa 66.67%

me studime të magjistraturës. Nga kjo mund të themi se niveli pedagogjik i arsimtarëve të shkollës së mesme është më i lartë se i shkollave fillore.


## Niveli pedagogjik i arsimtarit



**Tabela 2** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) –  
A posedon shkolla juaj sallë të edukatës fizike dhe sportit?

Label	A posedon shkolla juaj sallë të edukatës fizike dhe sportit?	SHMU		SHML	
		Valid	Missing	Valid	Missing
		33	0	2	0
		Count	Percent	Count	Percent
1	Po	28	84.84%	2	100%
2	Jo	5	15.16%	0	0%

“A posedon shkolla juaj sallë të edukatës fizike?” pyetja e cila është paraqitur në tabelën 2 arsimtarët e edukatës fizike janë përgjigjur në këtë mënyrë: ata të shkollave fillore apo 84.84% kanë dhënë përgjigje po, ndërse 15.16% kanë deklaruar se nuk kanë sallë të edukatës fizike. Nga 5 arsimtarët e shkollës së mesme të këtij hulumtimi përgjigje kanë dhënë 3, por prej tyre 3 posedojnë sallë të edukatës fizike dhe 0 nuk posedon.






**Tabela 3** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Sa është e kënaqshme gjendja ekzistuese e sallës së edukatës fizike dhe sportit?

Label	Sa është e kënaqshme gjendja ekzistuese e sallës së edukatës fizike dhe sportit?	SHMU		SHML	
		Valid	Missing	Valid	Missing
		33	0	2	0
		Count	Percent	Count	Percent
1	1	0	0.00%	0	0.00%
2	2	3	9.0%	0	0%
3	3	10	30.30%	0	0.00%
4	4	12	36.45%	1	50%
5	5	8	24.24%	1	50%


**Tabela 3** paraqet të dhënat në pyetjen: Sa është e kënaqshme gjendja ekzistuese e sallës së edukatës fizike dhe sportit? Vlerësimi është bërë me nota prej 1 (gjendja e pakënaqshme) deri në 5 (e kënaqshme). Për shkollën fillore prej 33 subjekteve që kanë dhënë përgjigje me notën 2 janë vlerësuar 3 subjekte, ndërsa me notën 3 janë vlerësuar 10 ndërsa me notën 4 janë vlerësuar 12, kurse me notën 5 janë vlerësuar 8 salla sportive. Në shkollat e mesme gjendja e sallave është më e kënaqshme se në shkollat fillore, shumica e arsimtarëve apo 50% kanë vlerësuar me notën 4, ndërsa 50% me notën 5.



**Tabela 4** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - A posedon shkolla juaj poligone sportive?

Label	A posedon shkolla juaj poligone sportive?	SHMU		SHML	
		Valid	Missing	Valid	Missing
		33	0	2	0
		Count	Percent	Count	Percent
1	Po	0	0.00%	1	50%
2	Jo	33	100.00%	1	50%


Në tabelën 4 .Sqarohet pyetja “A posedon shkolla juaj poligone sportive?” në të cilën subjektët janë përgjigjur në këtë mënyrë: tek shkollat fillore 100 % kanë dhënë përgjigje Jo. Kjo ka ndodhur edhe tek shkollat e mesme në të cilat nuk kanë ndërsa 50% ka dhënë përgjigje Po. Tek shkollat e mesme gjithashtu të gjithë subjektet kanë dhënë përgjigje 50 përqind JO.



**Tabela 5** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Sa është e kënaqshme gjendja ekzistuese e poligoneve sportive?

Label	Sa është e kënaqshme gjendja ekzistuese e poligoneve sportive?	SHMU		SHML	
		Valid	Missing	Valid	Missing
		Count	Percent	Count	Percent
1	1	0	0%	0	0.00%
2	2	0	0%	0	.00%
3	3	0	0%	1	50.00%
4	4	0	0%	1	50.00%
5	5	0	0%	0	0.00%


Në pyetjen “Sa është e kënaqshme gjendja ekzistuese e poligoneve sportive?” që është paraqitur në tabelën 5 shumica e arsimtarëve tek të dy nivelet e shkollave kanë dhënë vlerësim me notën 3 dhe 4 për gjendjen ekzistuese të poligoneve sportive.



**Tabela 6** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Sa ka hapësira brenda sallave të edukatës fizike dhe sportit?

Label	Sa ka hapësira brenda sallave të edukatës fizike dhe sportit ?	SHMU		SHML	
		Valid	Missing	Valid	Missing
		33	0	2	0
		Count	Percent	Count	Percent
1	Mjaftueshëm	0	0.00%	2	100%
2	Pamjaftueshëm	33	100.00%	0	0.0%


Në tabelën 6 është paraqitur pyetja “Sa ka hapësira brenda sallave të edukatës fizike dhe sportit?”, gjersa përgjigja te shkollat fillore është 100% e pamjaftueshme, te shkollat e mesme kjo hapësirë brenda sallave të edukatës fizike është 100% e mjaftueshme



**Tabela 7** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Sa është hapësira e poligoneve sportive nëpër shkolla?

Label	Sa është hapësira e poligoneve sportive nëpër shkolla?	SHMU		SHML	
		Valid	Missing	Valid	Missing
		33	0	2	0
		Count	Percent	Count	Percent
1	Mjaftueshëm	26	78.78%	2	100.00%
2	Pamjaftueshëm	7	22.22%	0	0.00%


**Tabela me radhë 7** paraqet pyetjen “Sa është hapësira e poligoneve sportive nëpër shkolla?”. Në këtë rast siç shihet në tabelë hapësira e poligoneve në të dy nivelet e shkollimit atij fillor dhe të mesëm në shumicën e rasteve është e mjaftueshme.



**Tabela 8** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Sa janë të shfrytëzueshme rekuizitat sportive në sallën e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?

Label	Sa janë të shfrytëzueshme rekuizitat sportive në sallën e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?	SHMU		SHML	
		Valid	Missing	Valid	Missing
		33	0	2	0
		Count	Percent	Count	Percent
1	1	0	0.00%	0	0.00%
2	2	3	9.09%	0	00%
3	3	12	27.27%	0	0.00%
4	4	10	30.33%	2	100%
5	5	8	24.25%	0	0.00%


**Tabela 8** paraqet pyetjen “Sa janë të shfrytëzueshme rekuizitat sportive në sallën e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?”. Në këtë pyetje arsimtarët kanë dhënë vlerësim me nota prej 1 deri 5. Shkollat fillore që janë vlerësuar me notën 4 apo 30.33% të tyre kanë qenë shumicën e rasteve, por ka qenë e vlerësuar edhe nota 5. Arsimtarët e shkollës së mesme kanë dhënë këtë vlerësim, me notë 4



**Tabela 9** - Pyetja për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Në çfarë niveli janë rekuizitat sportive që posedon salla e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?

Label	Në çfarë niveli janë rekuizitat sportive që posedon salla e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?	SHMU		SHML	
		Valid	Missing	Valid	Missing
		33	0	2	0
		Count	Percent	Count	Percent
1	1	0	0.00%	0	0.0%
2	2	4	12.12%	0	0.0%
3	3	6	18.18%	0	0.00%
4	4	13	39.39%	2	100%
5	5	10	31.31%	0	0.00%


Në tabelën 9 është paraqitur pyetja “Në çfarë niveli janë rekuizitat sportive që posedon salla e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?” dhe mundësitë e vlerësimit me nota për të dy nivelet e shkollimit. Në këtë pyetje arsimtarët kanë dhënë këso vlerësime: SHMU – 4 arsimtar kanë vlerësuar nivelin e rekuizitave me notë 2, me notë 3 kanë vlerësuar 18.18% arsimtar, ndërsa me notën 4 kanë vlerësuar 39.39% arsimtar, ndërsa me notën 5 janë vlerësuar 31.31% përqind. Shkolla e mesme si duket ka gjendjen më të kënaqshme se sa shkolla fillore vlerësimin me notën 4 e kanë dhënë 100% e të anketuarve.



**Tabela 10-** Pyetja për shkollat fillore - Sa realizohet planprogrami i orës së edukatës fizike dhe sportit?

Përgjigjet e mundshme	SHMU		SHML	
	Valid	Missing	Valid	Missing
	33	0	2	0
	Count	Percent	Count	Percent
100%	0	0.00%	1	50%
80%	16	48.48%	1	50%
60%	15	45.45%	0	0.00%
40%	0	0.00%	0	0.00%
20%	2	6.06%	0	0.00%

Në tabletën 10 është paraqitur pyetja “Sa realizohet planprogrami i orës së edukatës fizike dhe sportit?” tek shkollat fillore dhe mundësitë e përgjigjeve kanë qenë në bazë të përqindjeve prej 20% deri 100%. Planprogrami i orës së edukatës fizike në shkollat fillore realizohet më së shumti në 60-80% të rasteve, ndërsa tek shkollat e mesme 80-100% të rasteve.





### 11. Sa është numri i orëve të lëndës së edukatës fizike dhe sportit për një javë?


Në këtë pyetje të parashtruar të gjithë arsimtarët e edukatës fizike ata të shkollave fillore dhe të mesme janë përgjigjur në të njëjtën mënyrë. Përgjigja e tyre ka qenë ata kanë mësim 2 orë në javë për lëndën e edukatës fizike.

**Tabela 11** - Mundësia për shkollat fillore (SHMU) dhe shkollat e mesme (SHML) - Shëno numrin e nxënësve prezent gjatë orës së edukatës fizike dhe sportit.

	SHMU	SHML
<b>Mean</b>	<b>27.56</b>	<b>29.67</b>
<b>St.Error</b>	<b>1.71</b>	<b>1.21</b>
<b>St.Dev.</b>	<b>2.36</b>	<b>1.16</b>
<b>Kurt</b>	<b>-.82</b>	<b>3.37</b>
<b>Skeë</b>	<b>-.57</b>	<b>-1.70</b>
<b>Min</b>		
<b>Max</b>		

**Tabela 11 paraqet** mundësinë “Shëno numrin e nxënësve prezent gjatë orës së edukatës fizike dhe sportit” tek shkollat fillore mesatarja e nxënësve prezent të cilët ndjekin orët e edukatës fizike është 27.56 me një gabim në këtë mesatare prej 1.71 nxënësi.

Nxënësit prezent në shkollat e mesme janë më shumë në numër, mesatarja e këtyre nxënësve është 29.67 nxënës për klasë.




**Tabela 12-** Pyetja për shkollat e mesme - Sa është i harmonizuar niveli shkollor me planprogramin mësimor?

Përgjigjet e mundshme	SHMU		SHML	
	Valid	Missing	Valid	Missing
	<b>33</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>0</b>
	Count	Percent	Count	Percent
<b>100%</b>	<b>0</b>	<b>0.00%</b>	<b>1</b>	<b>50%</b>
<b>80%</b>	<b>18</b>	<b>54.54%</b>	<b>1</b>	<b>50%</b>
<b>60%</b>	<b>12</b>	<b>36.36%</b>	<b>0</b>	<b>0.00%</b>
<b>40%</b>	<b>3</b>	<b>9.09%</b>	<b>0</b>	<b>0.00%</b>
<b>20%</b>	<b>0</b>	<b>0.00%</b>	<b>0</b>	<b>0.00%</b>

**Tabela 12** paraqet pyetjet “Sa është i harmonizuar niveli shkollor me planprogramin mësimor?” tek shkollat fillore dhe të mesme. Shumica e arsimtarëve të shkollave fillore mendojnë se ky nivel është harmonizuar në 60% të rasteve. Përqindja tjetër e mbetur kanë ndarë mendimin e tyre në mundësitë e përgjigjeve 80% dhe 40%.

Shumica e arsimtarëve të shkollave të mesme mendojnë se ky nivel është harmonizuar në 80% të rasteve, por disa prej tyre kanë dhënë përgjigje edhe 100% të rasteve.




**Tabela 13-** Pyetja për shkollat fillore - Zhvillimi i njësive mësimore. Si e zhvilloni një njësi mësimore në lëndën e edukatës fizike dhe sportit apo (sa përqind e zhvilloni një njësi mësimore ne lëndën e edukatës fizike dhe sportit)

<b>Përgjigjet e mundshme</b>	<b>SHMU</b>		<b>SHML</b>	
	<b>Valid</b>	<b>Missing</b>	<b>Valid</b>	<b>Missing</b>
	<b>33</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>0</b>
	<b>Count</b>	<b>Percent</b>	<b>Count</b>	<b>Percent</b>
<b>100%</b>	<b>0</b>	<b>0.00%</b>	<b>1</b>	<b>50%</b>
<b>80%</b>	<b>8</b>	<b>24.24%</b>	<b>1</b>	<b>50%</b>
<b>60%</b>	<b>20</b>	<b>60.60%</b>	<b>0</b>	<b>0.00%</b>
<b>40%</b>	<b>5</b>	<b>15.16%</b>	<b>0</b>	<b>0.00%</b>
<b>20%</b>	<b>0</b>	<b>0.00%</b>	<b>0</b>	<b>0.00%</b>


Në tabelë janë paraqitur rezultatet në pyetjen e bërë: Si e zhvilloni një njësi mësimore në lëndën e edukatës fizike dhe sportit apo (sa përqind e zhvilloni një njësi mësimore ne lëndën e edukatës fizike dhe sportit). Kështu mësojmë se përgjigje për 60% kanë dhënë 60.60% e mësimdhënësve, ndërsa 24.24% e tyre 80% dhe 40% 15.16 përqind.

Në shkollat e mesme të larta kjo përqindje është më e lartë dhe arrin prej 80% deri 100% të realizimit të lëndës mësimore në edukatën fizike.



**Tabela 14** - Pyetja për shkollat fillore - Sa përqind e realizoni orën mësimore të lëndës së edukatës fizike dhe sportit me teori?

Përgjigjet e mundshme	SHMU		SHML	
	Valid	Missing	Valid	Missing
	33	0	2	0
	Count	Percent	Count	Percent
100%	3	9.09%	1	50%
80%	17	51.51%	1	50%
60%	12	36.36%	0	0.00%
40%	1	3.03%	0	0.00%
20%	0	0.00%	0	0.00%




**Tabela15** - Pyetja për shkollat fillore - Sa përqind e realizoni orën mësimore të lëndës së edukatës fizike dhe sportit me praktikë?

Përgjigjet e mundshme	SHMU		SHML	
	Valid	Missing	Valid	Missing
	33	0	2	0
	Count	Percent	Count	Percent
100%	1	3.03%	1	50%
80%	8	24.24%	1	50%
60%	18	54.54%	0	0.0%
40%	3	9.09%	0	0.00%
20%	2	6.06%	0	0.00%

Në tabelën 15 është paraqitur pyetjet “Sa përqind e realizoni orën mësimore të lëndës së edukatës fizike dhe sportit me teori dhe praktikë?” tek shkollat fillore. Në nivelin e shkollimit


fillor dhe të mesëm shumica e përgjigjeve për realizimin e orëve në teori dhe në praktikë janë dhënë në 60-80%.



**Tabela 16-** Pyetja për shkollat e mesme - Sa është përqindja e shfrytëzimit të këtyre ambienteve ne realizimin e orëve mësimore?

Përgjigjet e mundshme	SHMU		SHML	
	Count	Percent	Count	Percent
100%	1	3.03%	0	0.00%
80%	8	24.24%	2	100%
60%	18	54.54%	0	0.0%
40%	3	9.09%	0	0.00%
20%	3	9.09%	0	0.00%

**Tabela 16 paraqet** pyetjen “Sa është përqindja e shfrytëzimit të këtyre ambienteve ne realizimin e orëve mësimore?” tek shkollat e mesme. Sallat e edukatës fizike shfrytëzohen në të 60-80%, ndërsa tek shkollat fillore realizimi i orëve bëhet në shumicën e rasteve 60%.




**Tabela 17** - Pyetja për shkollat fillore - Sa janë funksionale këto ambiente gjatë realizimit të orës së edukatës fizike dhe sportit?

Përgjigjet e mundshme	SHMU		SHML	
	Count	Percent	Count	Percent
1	0	0.00%	0	0.00%
2	6	18.18%	0	0.0%
3	14	42.42%	0	0.0%
4	10	30.30%	2	100%
5	3	9.09%	0	0.00%

Në tabelën 17 paraqitet pyetja “Sa janë funksionale këto ambiente gjatë realizimit të orës së edukatës fizike dhe sportit?” tek shkollat fillore ambiente funksionale për realizimin e orëve të



edukatës fizike janë me notë 3, gjegjësisht 42.42% të rasteve, ndërsa me notën 2 kemi pasur 18.18% të rasteve. Shkollat e nivelit të lartë kanë pasur 100% të rasteve vlerësimin me notën 4.



## **Analiza e hipotezave te parashtruara më lartë.**

Hipotezat të cilat u parashtrun në projektpropozim të kësaj teme do të mbrohen në mënyrë që të vërtetohen apo të hidhen poshtë.

### **Hipoteza 1**

Pres që infrastruktura në objektet shkollore ku mbahet mësimi i edukatës fizike në komunën e Malisheës të mos jetë në nivel të duhur .

Kjo hipotezë është vërtetuar pasi që arsimtrët në komunën e Malishevës kanë dhënë përgjigje negative në lidhje me këtë aspekt.

### **• Hipoteza 2**

Pres që dallimet ndërmejt objekteve sportive ndërmjet shkollave fillore dhe të mesme të mos ket dallime të mëdha në këtë komuë.

Në këtë hipotezë mund të themi se është vërtetuar pjesërisht që është vërtetuar një dallim jo aq i madhë.

### **• Hipoteza 3**

Shpresojë që planprogrami i orëve të edukatës fizike është duke u realizuar sipas planifikimit në shumicën e shkollave fillore dhe të mesme në komunën e Malishevës.

Në hipotezën e tretë është vërtetuar se mund të pranohet pasi që planprogrami realizohet sipas planifikimit në shkollat e komunës së Malishevës.

## PËRFUNDIMI

Qëllimi dhe synimi për realizimin këtij projekti hulumtues, do të na mundesojë në përparimin proceseve për ngritjen e kapaciteteve në infrastrukturën e sportit nëpër shkolla fillore dhe të mesme në Komunën e Malishevës dhe në disa vende rurale në këtë komunë dhe duke e trajtuar lëndën e edukatës fizike dhe sportit nëpër këto shkolla shpresojmë se do të mundemi të arsyetojmë vlerën teorike dhe praktike të këtij komunë .

Në këtë punim janë përfshirë 10 shkolla nga komuna e Malishevës të ciklit fillor dhe të mesëm. Subjektët të cilët kanë marrë pjesë në këtë punim janë arsimtarët e edukatës fizike. Në grupin e parë të variablave e përbëjnë pyetjet për përgatitjen profesionale (edukimin) e profesorëve të edukatës fizike, gjendjen e infrastrukturës sportive në shkollë, hapësira në të cilën zhvillohet lënda e edukatës fizike dhe sportit, dhe në grupin e dytë hyjnë variablat të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin dhe realizimin e lëndës së edukatës fizike dhe sportit.

Niveli pedagogjik i arsimtarit në të shumtën e rasteve ka qenë me studime të mbaruara bechaler, pjesa tjetër kanë të kryer nivelin e studimeve master dhe në mesin e tyre ka pasur edhe nga një arsimtar me studime themelore dhe një me shkollë të lartë pedagogjike. Në shkollat fillore në 84.84 të rasteve ka pasur sallë të edukatës fizike, ndërsa te ato të mesme ka pasur sallë të edukatës fizike në 100% të rasteve. Hapësira e sallave sipas arsimtarëve është e pamjaftueshme dhe ato nuk janë të pajisura sa duhet me rekuizita. Gjendja e rekuizitave nuk është edhe aq e kënaqshme dhe ato nuk shfrytëzohen maksimalisht.

Gjendjen ekzistuese të sallave arsimtarët prej notës 1 deri në 5 e kanë vlerësuar me notën 3. Në shumicën e rasteve shkollat kanë poligone sportive, ato janë vlerësuar me notën 4, por hapësira e tyre është e pamjaftueshme.

Terrenet sportive shfrytëzohen maksimalisht në shkollat fillore dhe të mesme dhe janë vlerësuar me notën 3 dhe 4.

Planprogrami i lëndës së edukatës fizike realizohet prej 60-100% dhe numri i orëve të ed. Fizike është 2 orë në javë. Numri prezent i nxënësve në shkollat fillore mesatarisht sillet prej 26 deri 28, ndërsa tek shkollat e mesme prej 21 deri 26.

Planprogrami është i harmonizuar në 60-100% të rasteve, ndërsa niveli pedagogjik i arsimtarëve është i harmonizuar me planin mësimor. Njësitë mësimore zhvillohen në 80% të rasteve në shkollat fillore dhe të mesme.

Ora e edukatës fizike në teori realizohet në përqindje të madhe, ndërsa në praktikë 80%.

Në pyetjen “Cilat ambiente të punës i shfrytëzoni për realizimin e orës mësimore që posedon shkolla?” ata shfrytëzojnë sallën e edukatës fizike 40%, klasën mësimore 100%, terrenet 100%, ndërsa poligonet shfrytëzohen vetëm në 40% të rasteve.

Pyetja – Si është i ndarë numri i orëve sipas kategorive – tematikës së edukatës fizike?

Teoria e edukimit fizik mesatarisht gjatë vitit shpenzon 6.57 të orëve të përgjithshme të edukatës fizike. Sporti i atletikës 10 orë, gjimnastika sportive dhe ritmike rreth 12 orë, ndërsa sportet kolektive rreth 24 orë për shumicën e klasëve të shkollës fillore dhe të mesme. Aktivitetet në ujë dhe skijimi nuk zhvillohen fare për shkak të mungesës së terreneve për të zhvilluar këto aktivitete fizike.

Garave sportive ju dedikohen mesatarisht 6.4 orë në vit, piknikut 1 apo 2 orë dhe matjeve antropometrike dhe motorike saktësisht 4 orë në vit.

Duke e ditur rëndësin e lëndës si përfundim të këtij punim mendojmë se kushtet për zhvillimin e orëve të edukatës fizike janë për të dëshiruar duke pasur për bazë të dhënat që na i dha ky punim. Në të ardhmen duhet të investohet më tepër në infrastrukturën e shkollave dhe në pajisjen e tyre me rekuizita sportive në mënyrë që mësimi të mund të mbahet në kushte më ideale, pasi që shkolla është institucion parësorë që mund e duhet të bëjë edukimin fizik dhe sportiv të fëmijëve, një fëmijë që praktikon aktivitet fizik sportiv zhvillon sistemin e tij organik, lëvizorë, përvetëson aftësi kordinative të ekulibrit.

Sporti ka një ndikim shumë të rëndësishëm sidomos në ditët e sotme që lojrat e zakonshme fizike janë zëvendësuar nga ato elektronike që ndikojnë negativisht të fëmijët.

## LITERATURA:

1. Çitaku,F,(1981). *Hulumtim në hapësiren motorike në segmente të forcës, të shpejtësisë dhe të precizitetit, i ka realizuar me 118-sportistë aktiv (hendbollistë, basketbollistë dhe volejbollistë) të Ligës së Kosovës dhe të asaj federative\**. Elan, Prishtinë.
2. Gjinolli,E.(1983). “*Ndikimi i programeve të ndryshme të procesit mësimor të edukimit fizik në disa dimensione të statusit psikosomatik të nxënësve të klasëve të pesta të shkollave fillore*” Punim magjistrature, Zagreb
3. J. Malacko, D. Popovic.: *Metodologija kineziološko antropoloških istrazivanja*, Priština, 1997.
4. V. Šnajder.: *Razlike izmedju muskog i zenskog pola u bazicnim motorickim variablama. Kineziologija* 22 (1990), 1-2.
5. McCLOY, C. H.; *The measurement of general motor capacity and general motor ability. The suplement to the Research Quartely*, 5 (1945), vol.5, No. 1 pp.46-62.
6. MAVER, H.;MOMIROVIQ, K.; PADJEN, R.; *Analiza e disa testeve nga tereni, për kondicion fizik*. Zagreb, 1958.
7. ISMAIL, A.H.; GRUBER, J.J.; *Motor Aptitude and intellectual Performance*, Ch. E. Merill Books Collumbus, Ohio, 1967.
8. B SAHITI, *Bazat e Arsimit Fizik me Metodikë*, Tetovë, 2005
9. Besarta Seferi , Punim diplome Master “*Niveli Pedagogjikë dhe ndikimi i ifrastrukturës sportive shkollore në realizimin e plaprogramit të lëndës së edukatës fizike dhe sportive në komunën e Glllogocit*”, 2015.